



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 12/19) dhe nenit 40 paragrafi 1 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit duke vepruar për lëndën e formuar pas denoncimit të dorëzuar nga parashtues i panjohur (denoncim anonime), në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 14.12.2020, morri këtë

VENDIM

Procedura për lëndën me numër 12-4344/1 me datë 17.09.2019 e formuar pas denoncim nga parashtues i panjohur (denoncim anonime) e dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, **NDËRPRITET**.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për lëndën me numër 12-4344/1 me datë 17.09.2019, përshkak se akuzat në denoncim nuk janë vërtetuar.

Lënda me numër 12-4344/1 me datë 17.09.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e KSHPK në afat prej 5 (pesë) ditë nga koha e vendimmarrjes.

Sqarim

Lënda me numër 12-4344/1 me datë 17.09.2019 e formuar mbi bazë të denoncim së marrur nga parashtues i panjohur (denoncim anonime).

Në denoncim tregohet për akuzat për dyshime për veprime joligjore të ndërmarrura nga ana e investitorit lidhur me ndërtimin e objektit – ndërtesë në rr. lagjja, i cili gjatë ndërtimit të objektit në mënyrë joligjore jashta sipërfaqes së cilës i është dhënë leje ndëtim, ka ndërtuar shtylla prej betoni në trotoare që është në pronësi shtetërore.

Me qëllim që të kontrollohen akuzat në denoncim dhe caktimit të gjendjes faktike në rastin konkret, KSHPK dorëzoi Kërkesë për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve me numër 12-444/3 me datë 09.08.2020 me të cilën kërkon nga Komuna e Aerodromit t'i kontrollon akuzat në denoncim dhe për përfundimin e veprimeve ta informon Komisionin shtetëror.

Nga Komuna e Aerodromit me afatin kohor të caktuar me ligj ishte dorëzuar përgjigje për kërkesën e KSHPK.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit i merr parasyshtë akuzat e lëndës dhe të dhënat e dorëzuara nga institucione tjera kompetente, me çka e vërtetoti këtë:

- Investitori nëpërmjet sistemit elektronik e-Leje, dorëzoi Kërkesë me numër UP1 20-182 me datë 22.11.2018 për Miratim për ndërtimin e objektit banesor të kategorisë së dytë, në rrugën Pas mbarimi të procedurës administrative, komuna e Aerodromit dha Miratim për ndërtim me numër UP120-182 me datë 18. 04.2019, me plotfuqi me datë 02.05.2019.
- Me datë 13.03.2019 investitori dha lajmërim për fillimin e realizimit të aktiviteteve ndërtimore me Lajmërim nr. 29-30/1 me datë 13.03.2019. Me datë 09.05.2019 është bërë inspektim dhe është konstatuar me Procesverbal për konstatim nr. UP1 29-81 se investitori ndërton në bazë të Miratimit për ndërtim, mirëpo përshkak të rrezikut nga rrënimi në anëve të pjerrta gjatë themelit është dhënë Vendim për ndërprerje nr. IP1 29-81 me datë 09.05.2019, dhe investitori veproi dhe e menjanoi rrezikun me çka është konstatuar në Procesverbalin nga kontrollimi vëzhgues i inspektorëve me nr. IP1 29-81 me datë 15.11.2019.
- Është bërë mbikqyrje nga inspektorët me çka është konstatuar me Procesverbal nr. IP1 29-81/2019 me datë 15.06.2020, se në momentin e inspektimit dhe mbi bazë të matjeve në vendngjarje, objekti është ndërtuar mbi bazë të Miratimit për ndërtim nr. UP1 20-182 me datë 17.04.2019 dhe mbi bazë të projektit teknik të vulosur nr. IG 12/18F2018 punuar nga dhe nuk ka bazë për ngritje të procedurës për inspektim. Me gjendjen e re të konstatuar nga ana e komunës është konstatuar se nuk ka bazë për ngritje të procedurës për inspektim.

Në bazë të të shënuarës më lartë është vërtetuar gjendja faktike, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit ka konstatuar se kanë vepruar organet tjera kompetente (inspektor i autorizuar i ndërtimtarisë) të cilët në kuadër të komeptencave të veta ndërmorrën procese vepruese në përputhje me ligjin me qëllim që të caktimit të gjendjes faktike në rastin konkret dhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete në drejtim të mënjanimi të parregullsisë të caktuara dhe rreziqeve gjatë ndërtimit të objektit pas të cilave veprime investitori veproi dhe parregullsitë janë mënjeluar. Prej këtu KSHPK përfundoi se akuzat nuk janë vërtetuar, nuk ka elemente për veprime të mëtuqjeshme për rastin e lëndës dhe lënda duhet të mbyllet dhe të arkivohet. Duke marrë parasyshtë të lartëshënuarën, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi në dispozitë të këtij vendimi.

Punoi: m-r I.P
Miratoi: S.P.D. anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËROР ПЁР
PARANDALIM ТЁ
KORRUPSIONIT**
Kryetarë: Biljana Ivanovska

